



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi, personi nën hetim **Xhelil Alla** me datë **10.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj kërkuesit (personit nën hetim) me vendimin Nr. 54, dt. 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 237, 263/1 shkronja “b” dhe 266 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **706**, datë **11.12.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (personit nën hetim) **Xhelil Alla**.
2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj kërkuesit (personit nën hetim) **Xhelil Alla** me vendimin Nr. 54, dt. 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të afateve të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale.
3. Caktimin ndaj shtetasit **Xhelil Alla**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave*” e parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.
4. Urdhërohet personi nën hetim **Xhelil Alla** që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në ****.
5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim **Xhelil Alla** nga ambjentet e paraburgimit nëse ai nuk mbahet i arrestuar me ndonjë masë tjetër siguri “*Arrest në burg*” si i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale apo me ndonjë vendim dënimi me burgim.
6. Urdhërohet policia gjyqësore dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për zbatimin e këtij vendimi.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brënda 5 ditëve, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 11.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar